VENDIM
Nr.23, datë 20.1.1997

PËR DHËNIEN E FONDEVE TË EMERGJENCËS PËR OBJEKTIN "SISTEMIM ASFALTIM" NË QYTETIN E ÇOROVODËS

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondet e investimeve të buxhetit të tremujorit të parë të vitit 1997 të Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit miratohet vlefta prej 17 500 mijë lekësh për punimet e emergjencës në objektin "Sistemim-asfaltim" në qytetin e Çorovodës.

2. Forma e prokurimit për këtë fond të jetë e drejtpërdrejtë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi